

1. Kontakti	
1.1. Organizata kontaktuese:	Agjencia e Statistikave të Kosovës - ASK
1.2. Njësia kontaktuese në organizatë:	Departamenti i Statistikave Sociale – Sektori i Standardit të Jetesës
1.3. Emri i kontaktit:	Emina Deliu, Besa Haqifi
1.4. Funkzioni i personit kontaktues:	Shefe e sektorit për standardin e jetesës, Zyrtare e lartë në sektorin e standardit jetësor
1.5. Adresa e postës kontaktuese:	Rruga “Zenel Salihu” no 4. 10000 Pristina, Kosovo
1.6. Adresa e emailit kontaktues:	Emina.Deliu@rks-gov.net; Besa.Haqifi@rks-gov.net
1.7. Numri kontaktues:	+ 381 38 200 31 151
1.8. Numri kontakutes i faksit:	Nuk ka numër të faksit në dispozicion. Numri i faksit është i përgjithshëm: +381 38 235 033

2. Prezantimi i statistikave	
2.1. Përshkrimi i të dhënave:	<p>Objektivat kryesore të ABEF janë në radhë të parë sigurimi i të dhënave themelore të nevojshme për hartimin e politikave në nivel kombëtar dhe për sektorë të ndryshëm. Së dyti, anketa do të lehtësojë përcaktimin e nevojave apo krijimin e objektivave të cilat mund të identifikohen si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Marrja e të dhënave të nevojshme për të vlerësuar peshat e përdorura për llogaritjen e indeksit të çmimeve të konsumit (IÇK). • Të dhënat e përdorura si input për matjen e konsumit privat të familjes në llogaritë kombëtare (NA). • Të dhënat për analizën e mirëqenies dhe varfërisë në nivel vendi brenda afatit kohor të specifikuar. <p>Karakteristikat kryesore të të dhënave të caktuara janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shpenzimet e konsumit - Të ardhurat - Strehimit.
2.2. Sistemi i klasifikimit:	ABEF mbledh informacion mbi Shpenzimet për Konsum në bazë të Klasifikimit të Konsumit Individual Sipas Qëllimit (COICOP – niveli 5 shifror nga 2015), Sistemit Ndërkombëtar të Klasifikimit të Profesioneve (ISCO 88), Klasifikimit Evropian të Aktiviteteve Ekonomike (NACE Rev.2) dhe Sistemit Ndërkombëtar të Klasifikimit të Arsimit (ISCED 97).
2.3. Mbulimi nga sektori:	Statistikat mbulojnë sektorin e ekonomive familjare sipas shpenzimeve për konsum, të ardhurat dhe kushtet e jetesës, sektorin e Çmimeve (për llogaritjen e konsumit të Indeksit të Çmimeve - IÇK), sektorin e Llogarive Kombëtare (si input për matjen e konsumit privat të ekonomive familjare në llogaritë kombëtare LLK).
2.4. Konceptet statistikore dhe përkufizimet:	Anketa e ABEF-së bazohet në konceptet, përkufizimet dhe rekomandimet metodologjike të "Metodologjisë dhe Rekomandimeve të Eurostat për Harmonizimin e 2003 për ABEF". Konsumi përdoret si masë e mirëqenies individuale ose mirëqenies. Konsumi i amvisërisë llogaritet si vlera e përgjithshme e shpenzimeve të një familjeje për sendet ushqimore dhe jo-ushqimore të regjistruara në Anketën e Buxhetit të Ekonomive Familjare (anketa përfaqësuese kombëtare e kryer çdo vit), duke përfshirë vlerat e imputuara të

	<p>çdo pjese ushqimore të prodhuar në shtëpi të konsumuar nga ekonomia familjare.</p> <p>Të dhënat e mbledhura përmes ABEF gjithashtu sigurojnë informacion mbi standardet e jetesës, masën dhe përbërjen e konsumit total dhe shpenzimet e familjeve dhe karakteristikat e tyre socio-ekonomike.</p>
2.5. Njësia statistikore:	Ekonomitë familjare dhe anëtarët e ekonomisë familjare.
2.6. Popullsia statistikore:	Popullata e synuar përbëhet nga të gjithë personat që jetojnë në ekonomitë familjare private. Personat që jetojnë në familje kolektive dhe në institucione në përgjithësi janë të përjashtuar nga popullata e synuar. Kushtet për të marrë parasysh popullatën e zakonshme rezidente – rezidenca e personit në Kosovë në 12 muajt e fundit.
2.7. Zona referuese:	Kosova (niveli kombëtar).
2.8. Mbulimi kohor:	Seritë kohore janë në dispozicion nga viti referues 2002 në baza vjetore. Ka filluar me periudhën referuese qershor 2002 - maj 2003, qershor 2003 - maj 2004, qershor 2004 - maj 2005. Nga viti 2006 e tutje periudha referuese është viti kalendarik janar - dhjetor.
2.9. Periudha bazë	Nuk ka indeks të përdorur.

3. Përpunimi statistikor

3.1. Burimi të dhënave:	Të dhënat bazohen nga anketa. Korniza e mostrës u bazua në të dhënat dhe hartografia nga Regjistrimi i Popullsisë 2011. Për qëllimet e numërimit të regjistrimit, Kosova ishte ndarë në zona të numërimit (qarqe regjistruese, QR), të cilat janë segmente relativisht të vogla operative të përcaktuara për numërimin e regjistrimit. Një total prej 4626 QR-ve u përcaktua për Kosovën dhe këto u përdorën si njësi primare të mostrës (NPM) të përzgjedhura në fazën e parë të marrjes së mostrave për ABEF. Një total prej 300 QR të mostrës janë përzgjedhur për ABEF 2016. Brenda çdo mostre të QR-ve 8 ekonomi familjare janë përzgjedhur në fazën e dytë, për një madhësi totale të mostrës prej 2400 ekonomi familjare në vit. Anketa e Buxhetit është e stratifikuar në 7 regjione dhe urbane/rurale).
3.2. Shpeshtësia e mbledhjes së të dhënave:	Mbledhja e të dhënave është mujore.
3.3. Mbledhja e të dhënave:	Për të mbledhur të dhëna është përdorur Intervista personale e asistuar në letër (PAPI, ose IPAL). Pyetësorët janë: kryesisht për ekonominë familjare dhe Ditari për ushqim, pije dhe mallra. Periudhat referuese janë dhënë më poshtë: Ditari për ushqim dhe pije për 2 javë; Jo-ushqimore për 3 muaj, Mallra të qëndrueshme për 12 muaj; Dhuratat e pranuar për 1 muaj; Të ardhurat për 12 muaj të vitit paraprak; Bujqësi (shitur dhe prodhuar mallra dhe shpenzime) për 1 muaj.
3.4. Vlefshmëria e të dhënave:	Ri-kontaktimi në teren i ekonomive familjare. Kontrolla logjike, editimi dhe pastrimi të dhënave, krahasimi i të dhënave në nivel të agreguar për tre vitet e fundit, kalkulimi i shkallës së përgjigjes.
3.5. Hartimi i të dhënave:	Llogaritja e peshave themelore: pesha bazë për çdo familje të mostrës do të jetë e barabartë me inversin e probabilitetit të përzgjedhjes (llogaritur duke shumëzuar probabilitetet në çdo fazë të mostrës). Pesha e ekonomisë familjare do t'i bashkëngjitet çdo shënimi të familjes-mostër në dosjet e të dhënave.

	<p>Probabilitetet e mostrave në çdo fazë të përzgjedhjes duhet të mbahen në një Excel faqe me informacione nga korniza e mostrës për secilin QR të mostrës, në mënyrë që shanset e përgjithshme dhe peshat përkatëse të mund të llogariten. Probabilitetet e përzgjedhjes janë të bazuara sipas dizajnit të mostrës dy-fazore. Në fazën e parë një mostër e QR u zgjodh me probabilitet të barabartë brenda çdo strate (rajon, urban/rural), dhe në fazën e dytë një mostër prej 8 familjeve u zgjodh në çdo QR mostër. Zëvendësimi lejohet, secili EA ka 4 familje rezervë në rast të zëvendësimit.</p>
3.6. Përshtatja/rregullimi:	<p>Peshat janë rregulluar bazuar në faktorin e rregullimit i cili llogaritet bazuar në vlerësimin e numrit total të përgjithshëm të ekonomive familjare në nivel kombëtar.</p>

4. Menaxhimi i cilësisë	
4.1. Sigurimi i cilësisë:	<p>ASK është e angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në "LIGJIN Nr. 04/L-036 PËR STATISTIKAT ZYRTARE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS", ASK përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranura ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të saj, ASK ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). ASK ka zhvilluar një Deklaratë të Cilësisë e cila gjendet në faqen e internetit të ASK-së: http://ask.rks-gov.net/media/1889/deklarata-e-cilesise.pdf. Dokumenti përmban njëmbëdhjetë parime, në përputhje me parimet e CoP, si pavarësia profesionale dhe konfidencialiteti statistikor, në të cilat bazohet puna e ASK-së.</p>
4.2. Vlerësimi i cilësisë:	<p>Gjatë vitit 2017 Në Agjencinë e Statistikave të Kosovës është kryer procesi i vlerësimit të Sistemit Statistikor të Kosovës përmes qasjes "Peer Review".</p>

5. Relevanca	
5.1. Nevojat e përdoruesit:	<p>Objektivat kryesorë të ABEF janë në radhë të parë për të siguruar të dhënat themelore të nevojshme për hartimin e politikave në nivel kombëtar (Ministria e Punës dhe Ministria e Mirëqenies Sociale, Qeveria, Ministria e Arsimit, Universiteti, studentë në Master dhe Doktoratë). Së dyti, anketa do të lehtësojë përcaktimin e nevojave apo krijimin e objektivave të cilat mund të identifikohen si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Marrja e të dhënave që janë të nevojshme për të vlerësuar peshat e përdorura për llogaritjen e indeksit të çmimeve të konsumit (IÇK). • Të dhënat e përdorura si input për matjen e konsumit privat të familjes në llogaritë kombëtare (LLK). • Të dhënat për analizën e mirëqenies dhe varfërisë në nivel vendi brenda afatit kohor të specifikuar.
5.2. Kënaqshmëria e përdoruesit:	<p>Njëra ndër elementet kyçe për të siguruar cilësinë e të dhënave statistikore është matja e kënaqshmërisë së përdoruesve. Anketa ka për qëllim që të grumbulloj informacion të plotë mbi nevojat dhe kërkesat e përdoruesve dhe shfrytëzuesve</p>

	të të dhënave zyrtare statistikore. Me anë të kësaj ankete shfrytëzuesit e të dhënave statistikore kanë shprehur mendimet dhe opinionet e tyre lidhur me pikëpamjet statistikore, kanë dhënë këshilla dhe sugjerime lidhur me nevojat e tyre për statistika si dhe për përmirësimin e këtyre të dhënave statistikore në të ardhmen. Këtë vit u zhvillua për herë të dytë Anketa e kënaqshmërisë së përdoruesve. Qëllimi i këtij ankete është të matë nivelin e kënaqshmërisë së përdoruesve të të dhënave dhe të kemi informacion të plotë mbi nevojat dhe kërkesat e përdoruesve. Pyetësi u plotësua nga 34 përdorues, të përbërë nga 14 pyetje. Rezultatet e këtij studimi do të jenë në dispozicion në faqen e internetit të ASK-së.
5.3. Plotësia:	ISCED dhe ISCO klasifikimi i përdorur është i ndryshëm nga standardet dhe disa variabla mungojnë.
5.3.1. Data completeness - rate	Shkalla e mbulueshmërisë është 89%.

6. Saktësia dhe besueshmëria	
6.1. Saktësia e përgjithshme:	Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare mbulon të gjithë personat që jetojnë në ekonomitë familjare private. Ndërsa rezultatet bazohen në një mostër të popullsisë, ato i nënshtrohen llojeve të zakonshme të gabimeve që lidhen me teknikat e nxjerrjes së mostrave dhe intervistave, siç janë gabimet e nxjerrjes së mostrave, gabimet gjatë fazës së intervistimit, gabimet e matjes, gabimet e përpunimit dhe mosgjigjet. Gabimet e mostrimit shoqërohen nga devijime statistikore. Për këtë arsye, janë llogaritur devijimet standarde të zgjedhjes së përdorur për interpretimin e rezultateve të anketës.
6.2. Gabimi në mostra:	Efekti i rastësishëm për shkak të mostrimit do të thotë se rezultatet e llogaritura nga mostra të ndryshme devijojnë disi nga njëri-tjetri. Pasaktësia për shkak të dizajnit dhe përzgjedhjes së mostrës vlerësohet me gabimin standard të vlerësimit. Madhësia e gabimit standard ndikohet nga madhësia e mostrës dhe varianca e variablave që janë objekt studimi. Gabimi standard mund të përdoret për të llogaritur intervalin e besimit, brenda të cilit vlera e popullsisë qëndron me një probabilitet të caktuar.
6.2.1. Gabimi në mostra-tregusiit	Ekonomitë familjare mostër janë përdorur për të llogaritur vlerësimet e shpenzimeve (etj) për të gjitha ekonomitë familjare. Nëse mostra është mjaft e madhe, dhe të zgjedhur në mënyrë shkencore, pasiguria e vlerësimeve në përgjithësi do të jetë e vogël. Pasiguria shpesh shprehet me një interval besueshmërie. Vlera e vërtetë për të gjithë popullsinë pastaj pritët të jetë diku në mes të kufirit të besimit të ulët dhe të sipërm, me një probabilitet të lartë (këtu 95%). Intervalet e besimit për disa nga variabilet kryesore në ABEF janë si më poshtë:

Variabla	Llogaritja	Gabimi standard	95% intervali i besimit		Koefficienti i variacionit
			I ulët	I lartë	
Konsumi i përgjithshëm, milion €	2321	28,47	2265	2377	1,23
Shpenzimet për Ushqim	3181	41,14	3100	3262	1,29
Shpenzimet për Pije alkoolike dhe Duhan	308	9,90	288	327	3,22
Shpenzimet për Veshje dhe Veshwmbathje	343	10,09	323	363	2,94
Shpenzimet për Banim	2205	41,90	2122	2287	1,90
Shpenzimet për Mobilje	268	6,97	255	282	2,60
Shpenzimet për Shëndetësi	226	19,91	187	265	8,81
Shpenzimet për Transport	325	10,04	305	344	3,09
Shpenzimet për Komunikim	220	4,14	212	228	1,89
Shpenzimet për Rekreacion dhe Kulturë	43	3,56	36	50	8,33
Shpenzimet për Arsim	23	2,81	17	29	12,21
Shpenzimet për Restorantet dhe Hotelet	182	9,17	164	200	5,04
Shpenzimet për Shërbime të Tjera dhe Mallra	217	8,01	201	233	3,69
Konsumi i përgjithshëm	7539	92,43	7357	7721	1,23

6.3. Gabim jo-i mostrave: Gabimet e mos marrjes së mostrave janë gabimi që kanë ndodhur gjatë fazave të tjera të anketës: Gabimi i mbulimit janë gabimet që lidhen me kornizën; divergjencat midis kornizës dhe popullatës së synuar. Gabimet që ndodhin gjatë grumbullimit të të dhënave, gabimet e përpunimit dhe gabimi i mos përgjigjes kur anketa nuk arrin të marrë përgjigje ndaj një ose ndoshta të gjitha pyetjeve.

6.3.1. Mbulimi i gabimit Gabimet e mbulimit përfshijnë si mbi-mbulimin ashtu edhe nën-mbulimin. Përditësimi i fundit nga Regjistrimi i Popullsisë i vitit 2011 dhe ekonomite familjare të krijuara nuk janë të përfaqësuara mirë dhe gabimet lindin për shkak të dallimeve ndërmjet kornizës dhe popullsisë së synuar. Gabimi i nën-mbulimit është që njësitë e popullsisë së synuar nuk janë të qasshme nëpërmjet kornizës dhe ato gabime janë të vështira për t'u matur. Gabimi i mbi-mbulimit është gabimi për shkak të qasshmërisë së njësisë nëpërmjet kornizës që nuk i përkasin popullsisë së synuar. Fokusi kryesor ishte gabimi i mbi-mbulimit.

6.3.1.1. Mbi-mbulimi – norma, shkalla Mbi-mbulimi përbëhet nga ekonomitë famljare duke përfshirë zëvendësimin, e që janë: shtëpitë bosh, shtëpitë e shkatërruara, etj. Mbi mbulueshmëria është 7%.

6.3.1.2. Njësitë e përbashkëta - proporcioni Nuk është në dispozicion.

6.3.2. Gabimi në matje Të dhënat mblidhen nëpërmjet Intervistës Personale të Ndihmuar me Letër (PAPI) të mbikqyrur nga zyrat rajonale. Intervista është bërë nga stafi profesional-punonjës i përhershëm; Trajnimi adekuat i intervistuesve - për të shmangur refuzimin dhe gabimet; Intervista e ndarë në dy pjesw Pjesa I & II (intervista ballë për ballë dhe me ditar); Kontrollimi në terren lidhur me cilësinë. Ri-kontaktimi i ekonomive familjare pas intervistimit.

6.3.3. Gabimi në mos-përgjigje	Gabimet e mos përgjigjes janë gabimet kur anketa nuk arrin të marrë përgjigje ndaj një ose ndoshta të gjitha pyetjeve.
6.3.3.1. Njësia jo-përgjigje - norma për P	Mostra me njësitë e suksesshme të intervistuar është 1802 ekonomi familjare nga anketa bazë plus 511 ekonomi familjare të zëvendësuar. Shkalla e papeshuar e mos përgjigjes nga mostra bazë është 22%.
6.3.3.2. Artikulli jo-përgjigje - norma për P	Nuk është në dispozicion.
6.3.4. Gabimi në përpunim	Gabimet gjatë përpunimit të të dhënave janë për shkak të gabimeve teknike.
6.3.4.1. Norma e Imputimit	Nuk është në dispozicion.
6.3.5. Gabimi në supozim të modelit	Nuk është në dispozicion.
6.4. Rishikimi i të dhënave	Nuk është në dispozicion.
6.5. Rishikimi i të dhënave - politika:	Në ASK nuk ka politika të rishikimit.
6.6. Rishikimi i të dhënave - praktika:	Nuk është kryer asnjë rishikim.
6.6.1. Rishikimi i të dhënave - madhësia mesatare	Nuk është në dispozicion.

7. Afati kohor dhe përpikëria	
7.1. Afati kohor:	Periudha referuese është nga 1 Janar 2016 deri me 31 Dhjetor 2016.
7.1.1. Vonesat në kohë – rezultatet e para	Nuk është në dispozicion.
7.1.2. Vonesat në kohë – rezultatet përfundimtare për P	Rezultatet përfundimtare me 12 Qershor 2017.
7.2. Përpikëria:	Te dhënat e ABEF 2016 janë publikuar në kohë.
7.2.1. Përpikëria - ofrimi dhe publikimi për P	Vonesa në kohë është 0.

8. Koherenca dhe krahasueshmëria	
8.1. Krahasueshmëria - gjeografike:	Statistikat i referohen vetëm nivelit kombëtar. Anketa e ABEF është përmirësuar vazhdimisht nga qershori 2002 për të përmbushur standardet dhe rekomandimet evropiane.
8.1.1. Asimetria për pasqyrën e rrjedhës së statistikave - koeficienti	Nuk është në dispozicion.
8.2. Krahasueshmëria nëpër kohë:	Nga qershori 2002 deri në maj të vitit 2005 periudha e referencës ishte nga qershori - maj (12 muaj). Nga viti 2006 e tutje periudha referuese është viti kalendarik janar - dhjetor.
8.2.1. Gjatësia e serive kohore të krahasueshme për P	Krahasueshmëria është nga 2002-2005. CC2 = 4. Krahasueshmëria është nga 2006-2016. CC2 = 11.
8.3. Koherenca – fushat e ndërlidhura:	Të dhënat vjetore të ABEF janë përdorur për strukturën e peshës për IÇK, në sektorin për Llogari Kombëtare për llogaritjen e Bruto Produktit Vendor (BPV) (BPV me qasjen e shpenzimeve). ABEF po ndjek çdo ndryshim në klasifikimet dhe definicionet në këto fusha statistikore.
8.4. Koherenca – statistikat gjysmë-vjetore dhe vjetore	Nuk është në dispozicion.
8.5. Koherenca - Llogaritë Kombëtare	Të dhënat nga ABEF përdoren nga Llogaritë Kombëtare.
8.6. Koherenca - e brendshme:	Të dhënat kontrollohen para se të finalizohen. Kontrollohen gjithashtu lidhjet midis variablave dhe koherenca në seri e tyre. Të dhënat janë koherente në aspektin e brendshëm.

9. Qasja dhe qartësia	
9.1. Njoftimet për shtyp:	Njoftimet për shtyp janë on-line në kohën e shpërndarjes së të dhënave. Përshkrimi shkurtër në dokumentacionin e metodologjisë përfshin konsumin , të ardhurat, si dhe të dhëna statistikore për çështjet tjera të ngjashme që kanë të bëjnë me standardin jetësor të ekonomive familjare në Kosovë.
9.2. Publikimet:	Publikimet e ASK-së, tabelat dhe materialet për njoftim për shtyp, janë gjithmonë në dispozicion në tri gjuhë: shqip, anglisht dhe serbisht.
9.3. Baza e të dhënave online:	ASK ka bazën e të dhënave online: http://askdata.rks.gov.net/PXWeb/pxweb/sq/askdata/?rxid=48d7fed2-90d9-4873-8854-c1e793ecafad .
9.3.1. Tabelat e të dhënave - konsultimet	Nuk është në dispozicion.
9.4. Qasja në mikro-të dhënat:	Përdoruesit nuk kanë qasje të drejtpërdrejtë në mikro-të dhënat, por me ligj studiuesit/hulumtuesit dhe institucionet mund të kërkojnë qasje përmes ASK-së.
9.5. Tjetër:	Të dhënat e AEFB publikohen edhe në Vjetarin Statistikor të ASK.. http://ask.rks.gov.net/sq/agiencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/vjetari-statistikor-i-republikes-se-kosoves-2017 .

9.6. Dokumentacioni mbi metodologjinë:	Metodologjia për ABEF është përshkruar në publikim në pjesën e metodologjisë së anketimit: http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/sociale/kushtet-e-jeteses .
9.7. Dokumentacioni për cilësi:	Metadata nga HBS 2015 janë dërguar në Eurostat.
9.7.1. Shkalla e plotësisë për metadata	Nuk është në dispozicion.
9.7.2. Metadata - konsultime	Nuk është në dispozicion.

10. Kostoja dhe barra

Intervistuesit e ABEF punojnë me kohë të plotë 14 në 7 zyra rajonale. Intervistuesit e ABEF me kontratë 4 (për zonën e serbëve). Personat që bëjnë kontrollin logjik dhe vënien e materialeve në futjen e të dhënave 2. Personat që bëjnë kontrollin pas futjes së të dhënave, prodhimi i tabelave dhe publikimeve 200 familje intervistohen çdo muaj 2400 në vit. Koha e kaluar në familje është rreth 15 minuta gjatë vizitës së parë, 1 orë gjatë vizitës së dytë, dhe 1 orë gjatë vizitës së fundit. Përveç që familja duhet të plotësoj Ditarin e shpenzimeve gjatë dy javëve, pjesa tjetër e kohës së kaluar është vështirë të vlerësohet.

11. Konfidencialiteti

11.1. Konfidencialiteti - politika:	"Agjencia do të sigurojë që të dhënat individuale të mbledhura për qëllime statistikore, të mbledhura nga persona fizikë ose juridikë, apo organet dhe organizatat e administratës publike (më tej "Responentët"), të trajtohen në mënyrë rreptësishtë konfidenciale dhe të përdoren vetëm për qëllime statistikore. Ligji 04/L-036, Neni 34. "Të gjithë të anketuarit (responentët) janë të detyruar, në pajtim me ligjin në fuqi, të bashkëpunojnë dhe të ofrojnë të dhëna në kohë dhe me saktësi statistikore në Agjenci, dhe të bashkëpunojnë me Agjencinë për të verifikuar saktësinë e të dhënave të mbledhura. LIGJI Nr. 04/L-036 PËR STATISTIKAT ZYRTARE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, Neni 21: http://ask.rks-gov.net/media/2023/ligji-per-statistikat-zyrtare-te-republikes-se-kosoves.pdf .
11.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave:	Qasja në të dhënat konfidenciale do t'u lejohet vetëm personave të cilët janë përgjegjës për prodhimin e statistikave zyrtare deri në atë nivel që këto të dhëna janë të nevojshme për prodhimin e statistikave. Neni 37, Ligji Nr 04/L-036: http://ask.rks-gov.net/media/2023/ligji-per-statistikat-zyrtare-te-republikes-se-kosoves.pdf .

12. Komentimi Fillimi

